




# FUQIA NË DUART TONA



## DUART TONA MBAJNË DEMOKRACINË


LEKË (10), BLEND (10), OLISA (10), LIZA (10), LIRZA (10), BEART (10), OLTİ K. (10), ENDRINA (10),  
LEON (10)



### Artikulli ynë flet për demokracinë, për institucionet demokratike dhe për të drejtat e barabarta

Fjala demokraci do të thotë shtet dhe drejtësi. Fjala „demos“ do të thotë popull, kurse „kracia“ do të thotë udhëheqje. Demokracia ndahet në dy lloje. Ato janë: demokracia direkte dhe ajo përfaqësuese. Në demokracinë direkte populli merr drejtpërdrejtë vendimet, kurse në demokracinë përfaqësuese do të thotë kur populli i zgjedh me anë të votave përfaqësuesit e tij. Ndërsa, përfaqësuesit marrin vendimet për popullin. Këta përfaqësues quhen deputetë, dhe ata bëjnë pjesë në Kuvend. Në Kuvend deputetët miratojnë ligjet, kurse Qeveria i zbaton ato, dhe gjykata merr vendime në bazë të atyre ligjeve. Gjykata është organ gjyqësor, i cili është i drejtë dhe i trajton të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë. Kushtetuta është libër me nene,

të cilat duhet t'i zbatojmë. Kuvendi i Kosovës përbëhet nga deputetë shqiptarë dhe deputetët nga komunitetet jo shumicë. Komunitetet jo shumicë përfshijnë serbët, ashkalinjtë, romët, egjiptianët, turqit, boshnjakët, etj. Në demokraci zbatohen dhe respektohen të drejtat e secilit. Ne kemi të drejtën e shkollimit, të drejtën e lojës, të drejtën për të pasur një familje, të drejtën e strehimit, të drejtën e shoqërisë, të drejtën e ushqimit, të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje, të drejtën për të shprehur opinionet, të drejtën për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë pa marrë parasysh gjininë, ngjyrën, fenë, vendin ku jeton, vendin ku ka lindur, apo nëse jemi të varfër ose të pasur. I gjithë grupi ynë mendon se të gjitha të drejtat dhe ligjet duhet respektuar. Përveç këtyre të drejtave, ne mendojmë se të gjithë qytetarët duhet të marrin pjesë në demokraci duke e forcuar atë dhe duke e forcuar njëri-tjetrin.



Votoni për demokraci



Grupi i specializuar për demokraci

# KUVENDI, SHTËPI DEMOKRATIKE

DREJTA (10), LEART (11), YLL JONA (10), ELTON (10), ARIS (10), ERINA (10), LEKË (10), LYRA (10)

**Kuvendi është vendi ku ne si qytetarë mund të propozojmë projektligje. Ato miratohen nga deputetët e Kuvendit të Kosovës**

Kosova, vendi ynë është shtet demokratik parlamentar. Ne kemi Kuvendin e Kosovës, i cili gjendet në kryeqytet në Prishtinë. Aty punojnë Kryetari i Kuvendit, deputetët e pozitës dhe opozitës, deputetët e pavarur, etj. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë. 100 prej tyre janë shqiptarë, kurse 20 të tjerë i takojnë komuniteteve jo shumicë. Këto komunitete jo shumicë janë: komuniteti serb, egjiptian, boshnjak, turk, etj.

Kuvendi ndryshe quhet Parlament, ku të drejtën për të propozuar projektligje e kanë Qeveria e Kosovës, Presi-

denti i Kosovës, 10.000 qytetarë, si dhe vetë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Për miratimin e këtyre ligjeve mbahen mbledhjet, të cilat quhen seanca plenare. Kuvendi i Kosovës kryen tri funksione kryesore. Ato janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni kontrollues. Funksioni përfaqësues do të thotë se deputetët janë përfaqësues të popullit. Funksioni tjetër është ai legjislativ, ku deputetët kanë të drejtë të propozojnë ligje dhe t'i miratojnë ato. Dhe funksioni i tretë është ai i kontrollit, ku Kuvendi mbiqëqyr Qeverinë duke i mbrojtur interesat e qytetarëve. Me plot punë dhe përgjegjësi, ky është Kuvendi i Republikës së Kosovës.



Kuvendi i Republikës së Kosovës



Duke punuar për artikullin tonë



Qytetarët e Kosovës



Demokraci për të gjithë



## ARSYEJA PSE NDAHEN PUSHTETET

HOLTA (10), LISI SH. (10), ART (10), DIELL (10), LISI H. (10), ANA (10), ELSA (10), KLESTA (10),

ANIKA (10)

### Institucionet e pushtetit në Kosovë

Ndarja e pushtetit bëhet për arsye që të drejtat të jenë të barabarta. Po ashtu, edhe që të mos ngarkohet vetëm një institucion. Tri pushtetet janë: Pushteti Legjislativ - Kuvendi, Pushteti Ekzekutiv - Qeveria, dhe Pushteti Gjyqësor - Gjykata. Qeveria propozon ligjet. Ndërkaq, Kuvendi i aprovon ato ose jo. Kurse, detyra e gjykatave është të gjykoj qytetarët nëse ata e shkelin ligjin. Në Kosovë kemi tri lloje të gjykatave: Gjykata Supreme, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. Qëllimi i këtyre institucioneve është sigurimi i mirëqenies tonë, pra e popullit. Propozimi ynë është që në të ardhmen të mos ketë konflikte politike, por të mbesim gjithmonë një vend demokratik.



Autorët e artikullit



Unë jam Gjykata. Marr vendim për persona që shkelin ligjin



Unë jam Qeveria. Propozoj ligje



Qytetarët në demokraci



Unë jam Kuvendi. Miratoj ose jo ligjet

# KONTRIBUTI YNË SI QYTETARË AKTIV

YLLZA (10), ARON (10), RUENA (10), TESA (10), ALDIN (10), GJIN (10), OLT E. (10), OLT I. (10), TEA (10)

## Mendimet tona si qytetarë aktiv

Sipas ligjit, të gjithë qytetarët janë të barabartë pa dallime feje, moshe, race, apo gjinie. Ne të gjithë e kemi të drejtën e të shprehurit dhe kjo është një element i demokracisë. Ne e kemi të drejtën e shkollimi, sepse shkolla është foleja e diturisë. Po ashtu, ne kemi edhe të drejtën e punës.

Qytetaria aktive lidhet me demokracinë, sepse liria e të shprehurit që e kemi ne qytetarët lidhet me demokracinë dhe me të drejtat tona.

Qytetarë aktiv mund të jenë qytetarët që bëjnë gjëra të mira për vendin e tyre. Edhe ne mund të jemi qytetarë aktiv duke kontribuar për të mirë në familje, në shkollë, në lagje dhe në shtet.



Gazetarët e demokracisë



Mësimet tona për qytetarinë aktive



Mbledhja e qytetarëve për një problem të caktuar



Ne duhet ta ruajmë ambientin e vendit tonë



Duke punuar në grup





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Faik Konica“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-5  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë